VENDIM
Nr.328, datë 22.4.2020

PËR DHËNIEN NË PËRDORIM TË PËRKOHSHËM, PA SHPËRBLIM, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TE SHËRBIMI INFORMATIV I SHTETIT, TË KATIT PËRDHES, NË OBJEKTIN NR.1, TRE KAT, PJESË TË PRONËS NR.1047, ME EMËRTIM "REPARTI USHTARAK NR.6620 (PU)", ME VENDNDODHJE NË LAGJEN "30-VJETORI", BERAT, DHE PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR.114, DATË 17.2.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR KALIMIN NË PËRDORIM TË PËRKOHSHËM, PA SHPËRBLIM, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TE DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARKIVAVE, PËR DEGËN E ARKIVIT SHTETËROR VENDOR NË BERAT, TË KATIT TË PARË E TË KATIT TË DYTË TË OBJEKTIT NR.1, DHE OBJEKTIT NR.2, PJESË TË PRONËS NR.1047, ME EMËRTIM "QENDËR MOBILIZIMI", ME VENDNDODHJE NË BERAT"

(ndryshuar me VKM nr. 718, datë 16.9.2020)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10 e 12, të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien në përdorim të përkohshëm, pa shpërblim, për një periudhë 20-vjeçare, nga Ministria e Mbrojtjes te Shërbimi Informativ i Shtetit, të katit përdhes, me sipërfaqe 198 (njëqind e nëntëdhjetë e tetë) m2, në objektin nr. 1, tre kat, pjesë të pronës nr. 1047, me emërtim "Reparti ushtarak nr. 6620 (PU)", me vendndodhje në lagjen "30-Vjetori", Berat, sipas planrilevimit dhe planimetrisë që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij, si dhe të sipërfaqes truall (oborr) prej 312 (treqind e dymbëdhjetë) m2, pjesë e pronës nr. 1047, sipas planrilevimit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për ta përdorur për vendosjen dhe zhvillimin e aktivitetit të administratës së Drejtorisë Vendore të Shërbimit Informativ të Shtetit, në Berat.

2. Shërbimit Informativ të Shtetit dhe Drejtorisë Vendore të Shërbimit Informativ të Shtetit në Berat iu ndalohet të ndryshojnë destinacionin e objektit të përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetërsojnë ose t'ua japin atë në përdorim të tretëve.

3. Ministria e Mbrojtjes, e përfaqësuar nga Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura, Policia Ushtarake dhe Shërbimi Informativ i Shtetit të lidhin aktmarrëveshje ndërmjet palëve për dhënien në përdorim të përkohshëm, pa shpërblim, të katit përdhes, me sipërfaqe 198 (njëqind e nëntëdhjetë e tetë) m2, në objektin nr. 1, tre kat, pjesë të pronës nr. 1047, me emërtim "Reparti ushtarak nr. 6620 (PU)", sipas planimetrisë, si dhe të sipërfaqes truall (oborr) prej 312 (treqind e dymbëdhjetë) m2, pjesë e pronës nr. 1047, sipas planrilevimit, me vendndodhje në lagjen "30-Vjetori", Berat, duke përcaktuar kushtet dhe detyrimet e ndërsjella ndërmjet palëve.

4. Vendimi nr.114, datë 17.2.2016, i Këshillit të Ministrave, "Për kalimin në përdorim të përkohshëm, pa shpërblim, nga Ministria e Mbrojtjes te Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, për Degën e Arkivit Shtetëror Vendor në Berat, të katit të parë e të katit të dytë të objektit nr.1, dhe objektit nr.2, pjesë të pronës nr.1047, me emërtim "Qendër Mobilizimi", me vendndodhje në Berat", shfuqizohet.

5. Ngarkohen ministri i Mbrojtjes, drejtori i Shërbimit Informativ të Shtetit dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

PLAN RILEVIMI
Prona nr.1047, "Rep. Usht. nr.6620, (PU) "

MIRATOHET
Komandanti i Repartit Ushtarak nr.6620
Kolonel Altin **KURTI**

DREJTORI I PIGJIU
Ark. Enea **SINOJMERI**

PUNOI
Topograf Nikoll TUSHI

IDENTIFIKIMI I PASURISE
Zona Kadastrale 8502.
Nr.Pasurise14/37 Vol.___Fq____
Indeksi i Hartes
BR;K-6,7, BR;L-6,7
Shkalla 1: 500
Adresa e pasurise Berat
Lagjia "30 Vjetori", Rruga "Koli VESHO", Berat.
Pronari :
Ministria e Mbrojtjes, Policia Ushtarake.

Korrik 2020

SISTEMI I KOORDINATAVE (KRGJSH)

SHPJEGUESE:
Sip.Përgjithshme= 1400.4 m²
Sip. nën objekte = 386.8 m²
Kufiri Repartit
Sip. e objektit të dhënë në përdorim SHISH me VKM nr.328, datë 20.04.2020 =198 m²
Sip. e truallit për t'u dhënë në përdorim SHISH =312 m²



SHENIM: Ky plan rilevimi u hartua , në zbatim të shkresës së SHSHPFA nr.3771/1, datë 15.07.2020, shkresës së PU nr.2639/1, datë 17.07.2020, bazuar në dokumentacionin hartografik të kësaj prone, të marrë në arkivin e IGJIU.

PLANIMETRIA E OBJEKTIT Nr1 KATI PERDHE
SIP e Ndertimit = 198 m2
SHKALLA 1:100



REP.SHQIPERISE MIN. MBROJTJES I.GJ.U.	DREJTORI	N/KOL: ARMIR ÇANI
	VIZATOI	Ing: A.MURATI
Q . R . M . BERAT	PERPILOI	Ing: A.MURATI
DATA 30/11/2011	KONTROLLOI	Ing. K. HYSENI